

Çmimi i paqes „Dr. Karl A. Lamers“

Thirrje për dorëzimin e punimeve



Fondacioni për paqe „Dr. Karl A. Lamers“, i themeluar në dhjetor të vitit 2018 ka për qëllim të nxisë të rinjtë për të menduar mbi rëndësinë e madhe të paqes dhe lirisë. Për të ardhmen e paqes dhe lirisë nevojitet përkushtim dhe pjesëmarrje e fuqishme e gjeneratës së re. Të dy këto vlera kanë pasur ndikim vendimtar në formësimin e jetës dhe punës së doktor Karl A. Lamers, si politikan shumëvjeçar. Është anëtar aktiv i Kuvendit Parlamentar të NATO-s (KP i NATO-s) që nga viti 1998, e ishte edhe kryetar i tij prej vitit 2010 deri në vitin 2012.

Fondacioni për paqe „Dr. Karl A. Lamers“ fton studentët t'i dërgojnë punimet e veta, për ta fituar çmimin që ndahet në bashkëpunim me KP të NATO-s. Tema e konkursit për vitin 2019 është:

NATO@70 – Si mund të vazhdojë Aleanca t'i kontribuojë paqes dhe lirisë në të ardhmen?

Kush mund të paraqitet:

Nxsim **studentët** që t'i dërgojnë punimet e veta në temën e dhënë. Pjesëmarrësit duhet të jenë prej **20 deri në 30 vjeç dhe të jenë shtetas të njërës nga anëtalet e NATO-s**. U lutemi që të keni parasysh se të drejtë pjesëmarrjeje kanë vetëm studentët me dokument të vlefshëm identifikues.

Çmimi i paqes „Dr. Karl A. Lamers“

Mënyra e dërgimit:

Ju lutemi që punimin Tuaj (deri në 2000 fjalë) ta dërgoni me e-mail në **peace@lamers-stiftung.de** deri më **31 korrik 2019**. Punimi duhet të jetë në gjuhën angleze. Secili pjesëmarrës mund të dërgojë vetëm një punim. Ju lutemi që ta shkruani emrin dhe mbiemrin tuaj, detajet e kontaktimit dhe sa vjet keni.

Përzgjedhja:

Juria për përzgjedhje, që përbëhet nga ish kryetarët, ish sekretarët e përgjithshëm dhe anëtarët tjerë të KP të NATO-s, bashkë me prof. dr. Sebastian Harnish (profesorin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikën e jashtme në Universitetin Hajdelberg), dr. Karl-Hajnc Kamp (kryetarin e Akademisë Federale për Politikën e Sigurisë së Gjermanisë në Berlin) dhe prof. dr. e nderit Karl A. Lamers, do t'i përzgjedhin tre punimet fituese.

Punimet fituese:

Tre fituesit e Çmimit për paqe „Dr. Karl A. Lamers“ (1,000€ për vendin e parë, 600€ për vendin e dytë dhe 400€ për vendin e tretë) do t'i shpallë kryetarja e KP të NATO-s Madlin Mun dhe prof. dr. i nderit Karl A. Lamers gjatë mbledhjes vjetore të KP të NATO-s në Londër.

Të dhënat personale që do të na i dërgoni i përpunojmë me qëllim të pjesëmarrjes në konkursin për punimin më të mirë dhe në këtë aspekt thirremi në nenin 6, par. 1b të dispozitës së përgjithshme mbi mbrojtjen e të dhënave për personat (GDPR). Me kërkesën tuaj me kënaqësi do t'ua dërgojmë letrën informuese, në të cilën thirremi në nenin 13 dhe 14 të GDPR-së.